

## **AKT THEMELIMI**

### **I SHOQERISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUARA ‘ FT CONSTRUCTION‘ SHPK**

Sot me date 10/10/2023 , une ortaku i vetem : Z.Filip Tola, i ditëlindjes 16.02.1969 , lindur ne Durres, banues ne Shijak,i pajisur me leternjoftim me nr personal G90216005D :

Ne baze te ligjit nr . 9901 date 14.04.2008 ‘Per tregtaret dhe shoqerite tregtare ‘ dhe ligjit nr.9723 date 03.05.2007 ‘Per qendren kombetare te regjistrimit ‘ kam vendosur te themeloj shoqerine me pergjegjesi te kufizuar “FT Construction “ SHPK.

#### **Neni 1 :**

##### **Emertimi i shoqerise**

Shoqeria do te quhet “FT Construction” SHPK dhe eshte person juridik shqiptar. Veprimtaria e saj rregullohet sipas neneve te ketij statuti , ligjit nr.9901 date 14.04.2008 si edhe ligjit per QKR.

#### **Neni 2**

##### **Selia e shoqërisë**

Shoqeria do te kete seline e saj ne Lagjen Rreth Xhafzotaj , Shijak – Nr pasurie 12/27, zona kadastrale 3225 . Shoqeria mund te krijojë dege , filiale , zyra përfaqësim ne te gjithë territorin e Republikës se Shqipërisë ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

#### **Neni 3**

##### **Objekti i veprimtarisë**

Shoqeria do te kete si objekt te veprimtarise se saj: Tregtim me shumice dhe pakice i mallerave te ndryshme industriale. Punime per ndërtimin e ujesjellesave, hekurudhave, mbikalimeve , punimeve nentokesore , veprave te artit etj. Punime me rere bituminoze , punime gërmimi ne toke. Punime civile dhe industriale. Punime betonimi , asfaltimi etj. Ndërtim , rikonstruksion , mirëmbajtje e rrugëve. Ndërtim , projektim , supervizim , kolaudim i objekteve civile , kulturore, industriale etj. Ndërtim linjash ujësjellësi. Tregtim tubi polietileni dhe gize. Tregtim i produkteve hidro.

#### **Neni 4**

##### **Kapitali i shoqërisë**

Kapitali i shoqërisë “FT Construction ’ shpk do te jete 100.000 Leke .

Ky kapital perbehet nga 1 (nje ) kuote dhe zoterohet ne masen 100 % nga ortaku i vetem Filip Tola.

## **Neni 5**

### **Kohezgjatja e shoqerise**

Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine e saj per nje periudhe kohore te pacaktuar .

## **Neni 6**

### **Organet e shoqerise**

1.Asambleja e përgjithshme

2.Administratori

### ***Asambleja e Pergjithshme***

Asambleja e pergjithshme eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet e meposhtme:

- Percaktimin e politikave tregtare te shoqerise.
- Ndryshimin e statutit.
- Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve.
- Emerimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar.
- Percaktimin e shperblimeve per administratorin,likuiduesin dhe ekspertin kontabel.
- Mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret,perfshire pergatitjen pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise.
- Zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit.
- Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre
- Perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve.
- Riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.
- Miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese.
- Ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statute.

### ***ADMINISTRATORI***

Administrator i shoqerise do te jete Z.Filip Tola , i datelindjes 16.02.1969 , lindur ne Durres , Shqiperi, banues ne Shijak , i pajisur me leternjoftimin me nr.personal G90216005D i cili emerohet per nje periudhe 5-vjeçare, me te drejte ripertesitje te ketij afati.

## **NENI 7**

### **Shperndarja e fitimit vjetor të shoqerise**

Pjesa e fitimit qe i takon secilit ortak nga vlera e fitimit vjetor te deklaruar ne pasqyrat financiare te shoqerise, vendoset te shperndahet nga asambleja e përgjithshme. Asambleja e Përgjithshme ka kompetence t'u shperndaje ortakëve pjesën e fitimit ne raport me vleren e kapitalit të regjistruar, qe kuotat e secilit ortak perfaqësojnë.

Po ashtu, Asambleja e Pergjithshme mund te vendose qe nje pjese e fitimit vjetor te mos u shperndahet ortakeve, por keto shuma te perdoren per zmadhimin e kapitalit fillestar apo per qellime të tjera, te cilat ajo i konsideron te dobishme per shoqerine.

## **NENI 8**

### **Prishja e shoqerise.**

Shoqeria priset :

a)kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj,

b)me vendim te asamblese se pergjithshme,

c) me hapjen e procedurave te falimentimit,

ç)nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr.9723 date 3.5.2007 per "OKR",

d) me vendim te giykates,

dh) per arsye te tjera te parashikuara ne statut.

## **NENI 9**

### **Likuidimi I shoqerise.**

Ne rast te likuidimit te shoqerise, Asambleja e Pergjithshme emeron nje likuidator, I cili administron shoqerine deri ne mbylljen e progesit te likuidimit.

Me vendimin e posacem te Asamblese se Pergjithshme, te marre me shumice te kualifikuar, pasi jane shlyer detyrimet ligjore ndaj kreditoreve te shoqerise,likuidatori shperndan pjesen e mbetur te pasurise se shoqerise ndermjet ortakeve. Kjo shperndarje

e fundit behet ne raport me vleren e kapitalit te regjistruar, qe kuotat e secilit ortak perfaqesojne.

Likuiduesit duhet te ftojne kreditorët per te depozituar pretendimet e tyre per prishjen e saj. Shoqeria e publikon dy here kete njoftim, me nje interval prej 30 ditesh, ne faqen e saj te internetit, si dhe ne faqen e internetit te Qendres Kombetare te Regjistrimit. Ne njoftim duhet deklaruar se pretendimet duhet te depozitohen brenda 30 diteve nga data e njoftimit te fundit.

## **NENI 10**

### **Perfundimi i likuidimit**

Pas shperndarjes se aktiveve te mbetura, likuiduesi e njofton qendren Kombetare te Regjistrimit per perfundimin e likuidimit dhe kerkon cregjistrimin e shoqerise.

Veprimtaria e likuiduesit nuk mund te kundershohet pas cregjistrimit te shoqerise nga Qendra Kombetare e Regjistrimit.

**Ortaku Themelues i Shoqerise 'FT Construction' SHPK**

**Filip Tola**

